



# Alfred Zylfi

Kryeauditues

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Z. Alfred Zylfi ka kryer studimet e larta në periudhën 1983–1987, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Dega Ekonomist për Industrinë. Gjithashtu, ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik, “Kursi i Kualifikimit të Specialistëve të Lartë me Njohuri të Përditësuar të Ekonomisë së Tregut”, dhe programet e studimit “Master në Ekonomi Agrare”, pranë Fakultetit të Ekonomisë Agrare, Drejtimi,“ Ekonomi dhe Politikë Agrare”.

Z. Zylfi ka eksperiencë të gjatë në administratën publike, përkatësisht në vitet 1987–1992 si Ekonomist i Kostos në Ndërmarrjen e Ndërtimeve Industriale Laç, në vitet 1992–1993, si Përgjegjës në Qendrën Ekonomike të Shëndetësisë Tiranë, në vitet 1993 – Nëntor 1998, si Kryetar i Degës së Organizimit dhe Furnizimit, Qendra Ekonomike e Çerdheve Tiranë.

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka filluar punë që nga viti 1998 e në vazhdim, duke pasur disa funksione, fillimisht si Kontrollor në Departamentin e Kontrollit të Sistemit Fiskal, Departamenti i Kontrollit të Ardhurave të Buxhetit, Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës, në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit si dhe në Drejtorinë e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit. Gjatë periudhës dhjetor 2022 – dhjetor 2024 ka kryer detyrën e “Drejtorit” të Departamentit të Auditimit të Performancës.

Aktualisht Z. Zylfi mban pozicionin e “Kryeaudituesit” në Departamentin e Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, Z. Zylfi ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik si trajnime të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në bashkëpunim me:


- Institucionin Suprem të Kontrollit të Anglisë (UK National Audit Office), “Kurs për trajnues”;
- Gjykatën Belge e Auditimit “Auditimi i buxhetit dhe raportimi mbi zbatimin e tij”;
- Gjykatën e Llogarisë të Holandës mbi “Trajnimin e Integritetit të Auditimit” dhe mbi “Metodologjinë e Auditimit të Performancës”;
- NIK Poloni mbi “Procedurat e auditimit në NIK” dhe “Auditimi i performancës dhe metodologjia”;
- Zyra Kombëtare e Auditimit në Suedi për auditimin e Performancës; - Gjykatën e Llogarive të Turqisë për auditimin publik;
- Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, dhe Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit (TAIEX), për auditimin financiar e të ligjshmërisë.


Z. Zylfi ka njohuri mbi gjuhën Angleze dhe Italiane.



## Kontakt

 [azylfi@klsh.org.al](mailto:azylfi@klsh.org.al)

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë  
Shqipëri

 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)